



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 40/2015

Prishtinë, më 4.12.2015, në orën 10:30

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-2

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa - kryetar, Sasha Milosavljeviq, Besim Beqaj, Raif Qela, Sala Berisha-Shala, Fatmir Rexhepi, Blerim Grainca, Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Visar Ymeri, Pal Lekaj, Enver Hoti, anëtarë.

Pjesëmarrës të tjerë: Avni Jashari, Arben Limani dhe Armend Hamzaj - AKP; Dardan Abazi - INDEP; Fjolla Uka dhe Albert Krasniqi - KDI; Shefki Kastrati - NDI; Blerta Bejtullahu - Euser/Eu; Blend Hyseni dhe Berat Thaçi - GAP; Kenan Gashi - Avonet; Kaltrina Ahmeti-GLPS, Norë Shabani- “Koha Ditore”.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 1.12.2015;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshim dhe plotësimin e Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit;
4. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit të Qeverisë për Bordin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë - ZRRE;
5. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit të Qeverisë për Bordin e Autoritetit Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare - ARKEP;
6. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 1.12.2015

Besim Beqaj, tha se për pikën e parë, ku ka raportuar ministri, është shkruar shumë si tekst dhe nuk është as transkript, e as procesverbal, madje edhe nuk është i lekturuar mirë, por vërejtje në përmbajtje nuk kam. Mirëpo, duhet ta jetë ose procesverbal, ose krejt transkript, e jo sikurse është hartuar në këtë formë.

Kryetari, tha se stafi i Komisionit nuk bën transkript, por procesverbal dhe kur ka ministra apo tema të ndjeshme, po e hartojnë më gjerësisht. Andaj, ne po vendosim që stafi të bëjë procesverbal vetëm për pjesën esenciale, ashtu siç e kanë të rregulluar dhe parashihet se si bëhet procesverbali, ndërsa kur kemi aso temash të ndjeshme, që ka nevojë për transkriptim, t'i urdhërojmë që për pikën e caktuar, të bëhet transkript dhe t'i bashkëngjitet procesverbalit.

Komisioni u pajtua me propozimin e kryetarit.

Procesverbali i mbledhjes së datës 1.11.2015, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshim dhe plotësimin e Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Kryetari, tha se kjo mbledhje është thirrur me urgjencë, për të shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Pra, është kërkesë edhe e Kryeministrit, i cili e ka dërguar dje me shkrim. Ai tha se ndryshimet janë vetëm në pjesën sa i përket zgjedhjes dhe përbërjes së Bordit të AKP-së. Pasi që në Ligjin për përmbylljen e mbikëqyrjes së pavarësisë janë lëshuar disa gabime, ku thuhet se numri i anëtarëve që duhet të jenë 8 (tetë) gjithsej, ku 5 (pesë) prej tyre propozohen nga Qeveria dhe 3 janë paraparë të propozohen nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar (ICO). Mirëpo, tani, me bartjen përgjegjëse nga Zyra Ndërkombëtare Civile, këto 3 propozime janë kompetencë e Qeverisë, prandaj lidhur me përbërjen e Bordit të AKP-së, ka ardhur në mënyrë urgjente për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, në mënyrë që të bëjnë këtë korrigjim teknik, por janë dhënë edhe disa specifikime lidhur me këtë çështje. Në fund, ngriti çështjen lidhur me vendimet që merren nga Bordi i AKP-së, me shumicë të thjeshtë, por edhe për disa vendime që duhet të jenë me 5 (pesë) vota pozitive.

Fatmir Rexhepi, kërkoi sqarim lidhur me nenin 14 të ligjit bazik për AKP-në, për procedurat e Bordit për pikën 7 dhe 8 për marrjen e vendimeve me 5 (pesë) vota pozitive, ku thuhet “sipas ligjit dhe rregulloreve”. Propozoi që të fshihet “sipas rregulloreve të Agjencisë”, pasi që krijon hapësirë për interpretime të ndryshme në marrja e vendimeve pozitive. Po ashtu, thuhet “vendimeve sipas ligjit”, ndërsa këtu në këtë projektligj, kurrkund nuk janë të paraqitura cilat janë ato vendime.

Raif Qela, kërkoi sqarim për nenin 12 lidhur me përbërjen e Bordit, për paragrafin 6.1 duhet të rregullohet në atë mënyrë që jo vetëm për rastin e një veprë penale që ka të bëjë me mashtrimin, por edhe të veprat të tjera penale, që prej të cilave çdo vepër penale e cila nuk është e rastësishme që mund të jetë edhe në trafik, kjo ka shumë rëndësi së po të lejohet kështu siç është lënë hapësirë për mundësit e veprave të tjera penale.

Besim Beqaj, në nenin 3, paragrafi 2, kur i referohet ligjit ose rregulloreve të AKP-së, që kanë të bëjnë me vendimet, ku duhet të jetë shumica e votave të kualifikuara me 5 (pesë) vota pozitive, propozoi që të fshihet fjala “e rregulloreve” dhe duhet të mbetet vetëm “sipas ligjit”, e jo edhe rregulloreve.

Sasha Milosavljeviq, pyeti për përbërjen e Bordit të AKP-së, lidhur me atë se në këtë Bord duhet të jetë një 1 përfaqësues i komunitetit jo shumicë. Nga cili komunitet pakicë duhet të jetë ky anëtar dhe a ka vend të garantuar për përfaqësimin e komunitetit serb?

Duda Balje, pyeti lidhur me përbërjen e Bordit AKP-së: A kanë të drejtë përfaqësimi në Bordin e AKP-së edhe komunitet e tjera jo serbe?

Avni Jashari-AKP, në cilësinë e anëtarit të grupit të punës, paraqiti ekspozenë e memorandumit shpjegues se cilat nene janë propozuar për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sqaroi se këtu ku thuhet “ligji”, është fjala për ligjin bazik dhe mandej sqarohet situata. Në grup të punës kemi propozuar që të jetë kështu, ndërsa tani, si Komision, e bëni me amendament dhe kjo rregullohet. Për çështjen e marrjes së vendimeve nga Bordi i drejtorëve të AKP-së, me anë të votimit me shumicë të thjeshtë dhe me vota pozitive, i shpjegoi se cilat vendime merren me shumicë të thjeshtë votash dhe me vota pozitive. Këto janë të rregulluara në ligjin bazik të AKP-së, në nenin 15. Lidhur me përbërjen e Bordit të AKP-së, tha se që nga viti 2002, ka pasur përfaqësues të komunitetit pakicë, por kjo varet prej Qeverisë se nga cili komunitet e propozon.

Kryetari, në fund kërkoi që për të gjitha çështjet që u paraqitën për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të sqarohen nga ana e Qeverisë dhe të nxirren amendamente në mes të dy leximeve. Po ashtu, kërkoi që të deklarohen me votim, deputetët lidhur me kërkesën e Kryeministrit që ky projektligj të futet në rend dite, me shmangie nga Rregullorja e Kuvendit.

Pas debatit, Komisioni, njëzëri, nxori këtë

Rekomandim

1. Miratohet në parim Projektligji nr.05/L-080 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr.04/L-115.

2. I propozohet Kuvendit që ta aprovojë kërkesën e Kryeministrit për procedurë të përshpejtuar lidhur me aprovimin e këtij projektligji.

3. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet deputeti, Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

4. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit të Qeverisë për Bordin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë - ZRRE

Kryetari, tha se duhet ta procedojmë tutje Propozim-Vendimin e Qeverisë për Bordin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRE-së), sepse Qeveria i ka propozuar Kuvendit, 3 (tre) kandidatë për anëtarë të Bordit të ZRRE-së, si vijon: Arsim Janova, Qemajl Musta dhe Besim Sejfiqaj.

Pra, këta shkojnë në pako në Kuvend dhe duhet ta miratojë Kuvendi, sepse Bordi i ZRRE-së ka vetëm 2 (dy) anëtarë, pra është jofunksional, ndërsa në anën tjetër e presin vendime të mëdha.

Fatmir Rexhepi dhe Besim Beqaj, paraqitën vërejtje sa i përket përgatitjes profesionale të të propozuarve, sepse kandidatët nuk kanë dhënë dëshmi për përgatitjen e tyre profesionale, por e kanë dërguar vetëm nga një shkresë, njëkohësisht, për kushtin ligjor për të mos qenë anëtar i ndonjë partie politike, duket se nuk është respektuar.

Raif Qela, lidhur më atë se sa i përket përgatitjes profesional nëpër Bord në përgjithësi e në veçanti të ZRRE-së, duhet të theksohet ajo se nuk mund të vazhdojmë të votojmë njerëz në pako përderisa ndonjeri prej tyre mund të jetë i pa përgatitur profesionalisht, mund të mos ketë kredi të moralit të mjaftueshme e tjera. Edhe mundësia që ne t'i votojmë ose të mos i votojmë fare në pako mendoj se duhet të eliminohet votimi në pako të ne në komision ose kur të bëhet në komision të kemi mundësi të përzgjedhjes veç e veç të kandidateve.

Kryetari, tha se i paqartë është edhe neni 5 i Ligjit për rregullatorin e energjisë, i cili në paragrafin 3, ku thotë, citoj: “3. Anëtarët Bordit gjatë mandatit të tyre në këtë pozitë nuk mund të jenë anëtarë aktivë të një partie politike” (nënparagrafi 3.2). Pra, mund të themi se ligji thotë se gjatë ushtrimit të mandatit nuk mund të jenë, mirëpo për këtë lë të na japë një sqarim me shkrim Zyra Ligjore e Kuvendit.

Pas debatit, Komisioni, njëzëri, nxori këtë

Konkluzion

Shtyhet shqyrtimi i Propozim-Vendimit të Qeverisë për Bordin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë – ZRRE, derisa për të tre kandidatët e propozuar për Bordin e ZRRE-së, nga Qeveria të sillen dëshmi (shkresa), ashtu siç e parasheh Ligji nr.03/L-185 për rregullatorin e energjisë, neni 5, paragrafi 2, nënparagrafi 2.1, 2.2 dhe 2.3 për kualifikimin, përvojën e punës dhe referencat tjera të përmendura në CV, vërtetim nga organet gjyqësore që ndaj tij nuk është duke u zhvilluar proces hetimor dhe nuk ka qenë i dënuar për vepër penale, si dhe një deklaratë nën betim, ashtu siç e përcakton neni 5, paragrafi 3, nënparagrafi 3.2 i ligjit.

5. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit të Qeverisë për Bordin e Autoritetit Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare - ARKEP

Kryetari, tha se edhe për këtë Bord i kemi vetëm CV-të e kandidatëve, prandaj propozoi që kjo pikë të shtyhet, sikurse u vendos edhe për Bordin e ZRRE-së.

Komisioni, pas debatit, njëzëri nxori këtë

Konkluzion

Shtyhet shqyrtimi i Propozim-Vendimit të Qeverisë për Bordin e Autoritetit Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare – ARKEP, derisa për të pesë kandidatët e propozuar për Bordin e ARKEP-it, nga Qeveria të sillen dëshmi (shkresa), ashtu siç e parasheh Ligji nr.04/L-109 për komunikimet elektronike, neni 78, paragrafi 5, 6, 7, 8, 9 dhe 10 për kualifikimin, përvojën e punës dhe referencat tjera të përmendura në CV, vërtetim nga organet gjyqësore që ndaj tij nuk është duke u zhvilluar proces hetimor dhe nuk ka qenë i dënuar për vepër penale.

6. Të ndryshme Çështje vijuese

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa